



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:268289

Datë: 08.10.2024

Numri i dokumentit: 06269776

C.nr.1913/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Shyqri Hoxha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Z.R. nga fshati Dushanoovë, Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. N.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, me seli në Prizren për çështjen juridike me objekt kontesti anulimi i kontratës dhe kthimi i pronës, vlera e kontestit 2000,00 (dy mijë) euro, pas shqyrtimit paraprak të padisë, jashtë seancës gjyqësore, me datën 08 tetor 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HIDHET POSHTË si e palejuar padia e datës 18 nentor 2019 e paditësit Z.R. nga fshati Dushanoovë, Komuna e Prizrenit, e parashtruar kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, me seli në Prizren për çështjen juridike me objekt kontesti anulimi i kontratës dhe kthimi i pronës, vlera e kontestit 2000,00 (dy mijë) euro.

A r s y e t i m

Paditësi Z.R. nga fshati Dushanovë, Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tij av. N.K. me datën 11 nëntor 2019, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë kundër të paditurit kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, me seli në Prizren për çështjen juridike me objekt kontesti anulimi i kontratës dhe kthimi i pronës, vlera e kontestit 2000,00 (dy mijë) euro.

Me shiqim në shkresat e kësaj lënde dhe duke u u përkujdesur sipas detyrës zyrtare, gjykata ka ardhur në përfundim se në këtë çështje kontestimore kemi të bëjmë me çështjen e gjykuar – res judicata, ngase në rastin konkret janë përmbushur të gjitha prezumimet juridike që kjo çështje të vlerësohet si çështje e gjykuar.

Deri tek kjo vendosje gjykata erdhi pasi që në regjistrat e kësaj gjykate gjeti se për të njëjtën çështje kontestimore, më saktësisht për të njëjtën kërkesëpadi të ushtruar nga i njëjti paditës, ka pasur të regjistruar padi pranë kësaj gjykate me datë 23 korrik 2013, e cila ka marrë numrin rendor C.nr. 655/13. Me anë të aktgjykimit të nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Civil nën numrin C.nr.655/13 të datës 03.02.2014, është aprovuar në tërësi kërkesëpadija e palës paditëse me të cilën ka kërkuar që të “Vërtetohet se është Nule kontrata mbi shitblerjen e paluatjshmërisë me numër Leg.nr.1109 e datës 06.11.1959, e lidhur ndërmjet paditësit si shitës dhe të paditurës Komuna Prizrenit si blerëse, dhe të vërtetohet se paditësi është pronar i paluatjshmërisë në vendin e quajtur “ Sheshi i Prizrenit”, e cila evidentohet si parcela katastrale nr. 7082 sipas fletës poseduese me nr.8414 ZK Prizren edhe atë në sipërfaqe prej 1515 m2, me kulturë arë e klasës së parë. “. Kundër këtij aktgjykimi është parashtruar ankesë nga ana e të paditurës Komuna e Prizrenit, pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës, ku me anë të aktgjykimit të saj Ac.nr. 4264/2014, të datës 26.11.2018, e ka aprovuar ankesën e palës së paditur dhe e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadijinë e palës paditëse Z.R. nga fshati Dojnicë, Komuna e Prizrenit.

Pas pranimit të këtij aktgjykimi të Gjykatës së Apelit, pala paditëse ka ushtruar revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës, ku me anë të aktgjykimit me REV. nr. 111/2019 të datës 08.04.2019, nga kjo gjykatë është refuzuar si i pabazuar revizioni i palës paditëse paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Ac.nr.4264/2014 të datës 26.11.2018.

Nga shiqimi i padisë dhe kërkesës së saj të parashtruar me datë 18 nëntor 2019, si dhe padinë dhe kërkesës së saj e ushtruar me datë 23 korrik 2013, gjykata gjeti se për të njëjtën kërkesë të paditësit, pra për anulimin e kontratës mbi shitblerjen e

paluajtshmërisë me nr. 1109/59 të datës 06.11.1959, e lidhur ndërmjet palës paditëse dhe asaj të paditur, si dhe vërtetimin e pronësisë për parcelën me numër 7082/1 sipas listës poseduese 8414 Zk Prizren, në sipërfaqe prej 1515 m², është vendosur me anë të aktgjykimi të Gjykatës së Apelit Ac.nr.4264/2014 të datës 26.11.2018, konfirmuar edhe përmes aktgjykimit të Gjykatës Supreme REV. nr. 111/2019 të datës 08.04.2019,, andaj për gjykatën kjo çështje kontestimore është çështje e gjykuar.

Bazuar në të lartëcekurat, gjykata vlerëson se pala paditëse eventualisht mund të inicoj procedurë përmbaruese, por jo të inicoj procedurë kontestimore në çështjen për të cilën tanimë është vendosur me aktgjykim të plotfuqishëm.

Me nenin 391 pika (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se *“pas shqyrtimit paraparak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po qeëse konstaton se, mes tjerash, çështja është e gjykuar (res judicata)...”*

Nga sa u tha më lart, e duke u bazuar në nenin 391 pika (d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.1913/19, datë 08 tetor 2024

Gjyqtari

Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas ditës së marrjes së të njëjtit, Gjykates së Apleit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.